

VENDIM

(i shkurtuar)

Nr. (11-2022-577) 146, datë 11.2.2022

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË FALIMENTIT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë nga:

GJYQTARE: Besjana Garxenaj,

asistuar prej sekretares Joana Vargu, sot më datë 11.2.2022, përfundoi në seancë gjyqësore publike shqyrtimin gjyqësor të çështjes civile me nr. regj. them. (42011-02792)296/520/165/3/603/519/558/2195, që u përket palëve:

PADITËS: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, përfaqësuar nga z. Stefan Samarxhi, sipas autorizimit nr. 18833/1 prot., datë 6.12.2017.

I PADITUR: Shoqëria “Artigian Cotto Albania” sh.p.k., me NUIS K81314518Q, me seli në Durrës, Sukth, te Stacioni i Trenit, me administrator z. Genti Sauku dhe administrator falimentimi znj. Lejla Shahu Dobi.

PERSONA TË TRETË: Banka Credins sh.a., me NUIS K31608801O, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, rr. “Vaso Pasha” nr. 8, përfaqësuar nga av. Oltion Myftari, autorizim datë 4.12.2017;

Tirana Bank sh.a., me NUIS J61924008V, me seli në Tiranë, rr. “Ibrahim Rugova”, përfaqësuar nga juristja znj. Fjona Kadiu, me autorizim datë 8.11.2021;

Shoqëria “Gold Dekor.AL” sh.p.k., me NUIS L71424508Q, me seli në Durrës, Sukth, ish-Stacioni i Trenit, me administrator Eduart Cenga.

Me pjesëmarrjen e: Avokaturës së Shtetit, Zyrës Vendore Durrës.

OBJEKTI: Për fillimin e procedurave të falimentit.

BAZA LIGJORE: ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar; neni 104, i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së falimentimit për shoqërinë tregtare “Artigian Cotto Albania” sh.p.k., me NUIS K81314518Q, me seli në Durrës, Sukth, te Stacioni i Trenit, sipas raportit të paraqitur nga administratorja e falimentit znj. Lejla Shahu (Dobi), me nr. 208 prot., datë 1.11.2021, protokolluar pranë Gj. Rr. Gj. Durrës me nr. 2291 prot., datë 2.11.2021.

2. Urdhërohet botimi i një kopjeje të shkurtuar të këtij vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Artigian Cotto Albania” sh.p.k., në faqen elektronike të Gjykatës, në Bashkinë Durrës, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

3. Shpenzimet gjyqësore për procedurën e falimentimit i ngarkohen debitorit.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga të gjithë palët e procedurës së falimentimit, në Gjykatën e Apelit Durrës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Durrës, më datë 11.2.2022.

GJYQTARE
Besjana Garxenaj